

PERMBAJTIE

0.0 HYRJJE	2
a) Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti.....	3
b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.	5
c) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;.....	5
ç) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis,	6
d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara.	7
dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis,	7
e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme	8
ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.	10

o.o HYRJE

Bashkia Has shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Kukës. Ajo kufizohet në jug me Bashkinë Kukës dhe në perëndim me Bashkinë Fushë-Arrëz, me të cilat e ndan liqeni i Fierzës në një gjatësi prej rreth 40 km. Në veri-perëndim kufizohet me Bashkinë Tropojë, me të cilën e ndan përroi i Skatinës. Në veri-lindje kufizohet me Komunitetet e Gjakovës dhe Prizrenit. Në përbërje të bashkisë ka 4 njësi administrative, 1 qytet dhe 29 fshatra. Sipas Censurit (2011), Bashkia Has ka një popullsi prej 16 790 banorësh me dendësi 35.49 banorë për km², ndërkohë sipas gjendjes civile ka 21 764 banorë. Qendra e bashkisë është Kruma, e shpallur qytet në 1972. Përgjatë viteve 1921-1925, ajo ka qenë qendra e Prefekturës së Kosovës që përfshinte Kukësin, Hasin dhe Tropojën. Emërtimi Has vjen nga emërtimi i kahershëm i trevës, gjysma e së cilës shtrihet në Kosovë.

Bashkia ka relief kodrinoro-malor, me lartësi mesatare 400-500 m mbi nivelin e detit dhe me kontraste të mëdha. Lartësia më e ulët mbi nivelin e detit është 296 m në bregun e liqenit të Fierzës, ndërkohë lartësia më e madhe është 1988 m në malin e Pashtrikut. Pyjet dhe kullotat zënë rreth 83.5 % të sipërfaqes dhe shtrihen në lartësitë mbi 1000-1200 m. Ato gjenden në bjeshkët e Krumës, Vranishtit, Gjinajve, Dajçit, Mujajve, Cahanit dhe Kishajve dhe përbëjnë një burim të qendrueshëm për zhvillimin e blegtorisë dhe turizmit malor.



a) Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti,

të shoqëruar dhe me imazhe të marra dt. 10. 02.2019

Sipas klasifikimit të përgjithshëm fitosociologjik të bimësisë së Shqipërisë shoqërimet bimore të zonës në studim i përkasin asaj të dushqeve gjetherënës. Ky brez shtrihet mbi brezin e shkurreve mesdhetare deri në lartësinë 1000m.

Ne zonen perreth objektit te kerkuar per shfrytezim bimësia është e pazhvilluar dhe e rrallë. Nëpër rrjedhat e proskave sezonale ku akumulohen depozitime dhe sedimente të shkrifta vërehen individë të rrallë të dushqeve dhe dëllinjës së kuqe. Zhvillim më i plotë i shoqërimeve shkurre vërehet në shpatet me pjerrësi nën 30%, zona në të cilët janë akumuluar depozitimet e shkrifta proluviale.

Zona në studim mbizotërohet nga vegetacioni i dushkajave, një grupim bimor i cili përfaqëson pyje gjethegjëra të përhapura përgjithësisht në brezin para malor dhe malor.Zona e shfrytezimit eshte shpat ne forme monoklinali zona eshte e degraduar, nuk ka bimesi por ne vende te rralla shkurre te pazhvilluara dhe barishte te ndryshme. Nuk gezon ndonje status te vecante mbrojtjeje per sa i perket flores, faunes dhe habitateve te ndryshme . Bimesia e rralle e saj nuk favorizon jetesen e kafsheve dhe shpendeve te ndryshme te egra Ne kufijte zones se shfrytezimit dhe jashte saj nuk ka ka livadhe, kullota dhe siperfaqe te mbjella te cilat mund te preken dhe demtohen nga aktiviteti i shfrytezimit ne te.

Pejsazhi karakteristik i zakonshem i zones nuk do te ndikohet nga ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit, mbasi zona e shfrytezuar nuk duket nga rruget. Projekti i shfrytezimit parashikon rimbjelljen e tyre dhe te drureve te tjere pyjore (pinus pinea, dhe pinus silvestris) duke ju dhene ne kete menyre nje status te favorshem mbrojtjeje.**Foto nga Objekti:**





b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.

Zona ku ndodhet objekti ka një shpërndarje të vaktit të perrenjve, prroskave, rrekeve etj. Ushqimi i vetëm i prurjeve të lengeta janë rreshjet e shiut dhe bores. Tipar karakteristik i rregjimit hidrologjik është luhajtja e theksuar e niveleve të tyre gjatë vitit që lidhet kryesisht me nivelin e reshjeve. Periudha me prurje të larta zgjat gjatë muajve Tetor-Maj dhe me prurje të pakta Qershor – Shtator. Rrjedhja minimale është e lidhur me rreshjet e pakta dhe avullimin e fuqishëm për shkak të temperaturave të larta. Rrjeti hidrografik i perrenjve përben zonën e drenimit edhe për objektin që do të shfrytëzohet. Nga monitorimi sistematik që do të bëhet prurjeve të ujit do të merren masa për kanalizimin dhe drenimin e tyre jashtë kontureve të punimeve minerare, poshtë horizontit të fundit të shfrytëzimit, duke marrë masa rigorozë që ato të mos behen shkak për demtimin e qendrave të banuara.

Në afërsi të zonës për shfrytëzim kalon perroi "Kishes" me prurje të ulet e cila derdhet në drinin e bardhë. Për sa i përket ujërave sipërfaqësore të cilat vijne sipasojë e reshjeve për të rritur qëndrueshmërinë e shpatit të shkallëve dhe për të parandaluar shkarjet, do të merren masa për kullimin e ujërave me kanale duke mos lejuar hyrjen e tyre në brendësi të punimeve minerare. Këto ujra do të jenë natyrore dhe do të shtojnë proskat e mesiperme.

Tharja e sipërfaqes së vendburimit dhe mbrojtja e tij nga hyrja e ujërave kryhet me anën e krijimit të rrjetit të kanaleve kullues. Dyshëmeja e këtyre kanaleve duhet të arrijë deri në shkëmbenjtë rrethues. Kanalet vendosen në krye të vendburimit ose gjithë perimetrin e tij duke nderprerë drejtimin e rrjedhës së ujërave. Uji i grumbulluar dërgohet nëpërmjet tyre jashtë kufijve të vendburimit në perroi ose lumin me të afërt.

c) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;

Çdo aktivitet minerar që zhvillohet për një leje minerare kërkim-zbulimi, shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis. Prandaj konform kërkesave të ligjit minerar e akteve që rrjedhin prej tij, nga shoqëria janë për punimet që do të zbatohen sipas këtij programi pune ka planifikuar shpenzime financiare për rehabilitimin e tij. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme. Industria minerare është shumë e rëndësishme në ekonominë e një vendi, por ajo shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative, të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasoje e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjeneruar, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Tabela e identifikimit të ndikimeve të mundshme negative në tokë.

	Ndikimi i mundshëm	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punës.	<i>Behet fjale për ndonjë rast të rrallë të rrjedhjes gjatë difekteve dhe çarjeve të tubave dhe sotokartit të mjeteve motorike dhe ndërrimit të vajrave në makineritë e karrierës gjatë prodhimit dhe transportit të mineralit.</i>

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	<i>Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorrike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.</i>
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive .	<i>Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive.</i>

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shqetesim i mundeshem i faunes.	<i>Ndikim i perkoshem.</i>

ç) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis,

ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve.

Në zonën në të cilën do të zhvillohet aktiviteti nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të veçantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket, mbasi sipërfaqja e objekti është po-thuajse e zhveshur nga bimësia. Megjithatë shoferet do të udhëzohen të bëjnë kujdes gjatë transportit në zona pyjore për të mos shtypur kafshë që mund të jenë në mes të rrugës.

1-Sasia e materialit dhe sterilizimit që do të dali nga gjurmimet do të sistemohet përgjatë rrugës, në anët e kanaleve të hapura dhe të përdoret për qëllime rehabilitimi në fazën e ndryshme të kërkesës së zbulimit ose për rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve të dëmtuara në përfundim të afatit të veprimtarisë minerare.

2. Do të piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit në sipërfaqet ku është germuar. Përgjatë segmenteve rrugore në varësi të terrenit dhe kushteve të tokës do të hapen kanale anësore që do të ndalim forcën gjeryese të ujërave të reshjeve. Në pjesë të veçanta do të shihet mundësia e mbjelljeve të fidanëve pyjore të përshtatshëm për zonën fito-klimatike.

3. Për parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes do të shfrytëzohen vendet e caktuara.

4. Makineritë që do të përdoren do të kontrollohen për gjendjen e tyre teknike dhe nëse konstatohen pjesë të amortizuara që mund të rrjedhin lubrifikante do të zëvendësohen me të reja. Në rast të ndonjë aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale të lëndëve ndotëse në mjedis do të merren masa për pastrimin e menjëhershëm të tokës së ndotur e cila do të depozitohet në një kazan të posaçëm metalik ose prej betoni për t'u djegur më pas.

5-Do të piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit në sipërfaqe. Përgjatë segmenteve rrugore në varësi të terrenit dhe kushteve të tokës do të hapen kanale anësore që do të ndalim forcën gjeryese të ujërave të reshjeve.

6. Makineritë duhet të mirëmbahen teknikisht që zhurma e tyre të jetë vetëm ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet të përdoren me efikasitet dhe të minimizohet koha gjatë se cilës mbahen ndezur motorët. Skapamentot duhet të kenë në gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike të kapjes së grimcave (skapamentot e makinerive kanë një jastëk të posaçëm për këtë gjë). Do të përdoret naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Transporti i materialeve të bëhet me mjete të pastra nga balta dhe të mbuluara nëse rrugët kalojnë pranë ose nëpër qendrat e banuara. Të mënjanohet rënia e borive të automjeteve nga shoferët për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banorët. Qarkullimi i kamionëve në qendrat e banuara të bëhet me shpejtësi të ulët gjë që shmang jo vetëm aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

7. Gjatë proceseve të punës nuk duhet të dëmtohen sipërfaqe të panevojshme si pasoje e mos planifikimit të saktë apo e neglizhencës së punëtorëve që mund të presin peme apo të shkaktojnë zjarre dhe dëmtojnë peizazhin dhe bimësinë e zonës.

d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar.

Ne zbatimin e programit të punës për këtë leje minerare kerkim-zbulimi do të shtrihet sipas afatit që përcakton Ligji Minerare dhe aktet nëligjore të miratuara në zbatim të tij *,që është 3 vjeçare*. Prandaj edhe investimet që parashikohen të bëhen nga shoqëria “PEPKOLA” sh.p.k do të shtrihen brenda këtij afatit të ndarë sipas fazave dhe rradhës së kryerjes së operacioneve të punës për realizimin e programit minimal dhe pajisjeve e makinerive që duhen. Në tabelën e mëposhtme jepet ndarja e investimit total në faza.

Në fazën e parë të kërkimit (viti i parë + vitin e dytë) të zonës minerare të kerkim zbulimit do të bëhet pastrimi i kanaleve ekzistuese, si dhe marrja e masave për realizimin e tyre. Gjatë vitit të parë do të informohet SH.GJ.SH në ecuri sipas 3 mujoreve etj. Gjithashtu që në fillim do të bëjmë të mundur hapjen e rrugës gjurmë dhe rrugëve të tjera për vajtje e mjeteve në objekt.

Gjatë vitit të dytë nga subjekti do të intensifikojmë punimet për kryerjen e punimeve dhe në varesi të rezultateve do të përgatitemi për marrjen e masave për kryerjen e shpimeve (hapja e rrugëve ndihmese dhe shesheve të shpimit, punimeve minerare) etj

Në fazën e dytë (vitin e tretë) në varesi të rezultateve që do të fitohen gjatë kryerjes së punimeve të kerkim-zbulimit të paraqitura në këtë projekt dhe të sipërfaqes që subjekti do të mbajë për zbulim do të hartohet një projekt me punimet e zbulimit i cili do të miratohet në Sh.Gj.Sh. Në këtë projekt do të paraqiten të gjitha punimet për zbulim si në volum ashtu dhe në vlerë monetare duke respektuar të gjithë legjislativin në fuqi.

dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis,

që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të madhe fizike, dhe objekti ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zona me e afert e banuar. Zhurmat që krijohen gjatë fazës së kerkimit zbulimit nuk përbejnë ndotje akustike. Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga këto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen në mesataren e frekuencës 100 – 150 Hz , e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqenëse në objekt do punohet vetëm me një turn. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.

e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Faza e punimeve gjeologjike në kuadër të kësaj leje minerare përfshin kryerjen e punimeve të natyrës së studimit gjeologjik, kërkim-zbulimit si kanale, punime të lehta sipërfaqësore si ç' veshje e kariera, galeri e shpime, të cilat kërkojnë investime të posaçme me hapje rrugësh për përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e tyre. Prandaj në investimet që parashikohen është planifikuara dhe zëri rikonstrukcion rrugësh dytësore për dërgimin e bazës materiale dhe makinerive në zonën e objektit.

Plani i mbylljes së veprimtarisë minerare për rastin konkret që është kërkim-zbulimi në zonën minerare 738/7, objekti i kromit "Gjinaj" konsiston:

- Demolimi dhe transporti i makinerive.
- Shkatërrimi i ndertimeve të ngritura për zhvillimin e aktivitetit minerar, si zyra, objekte trajtimi e objekte industriale
- Sistemimi i mbetjeve të krijuara gjatë periudhës që vazhdon veprimtaria minerare
- Rehabilitimi i sipërfaqeve të demtuara nga zhvillimi i këtij aktiviteti

Mbyllja e hyrjeve të galerisë dhe marrja e masave të sigurisë

Shoqëria do të mbyllë menjëherë pas përfundimit të veprimtarisë grykën e galerive që do të shërbejnë për kërkim-zbulimit të këtij objekti, duke u siguruar që të mos jete e mundur hapja e tyre me mjete rrethore nga banorët. Kjo do të bëhet konform legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe mbylljen e minierave.

b) Sistemimi i sheshit të depozitimit të mineralit pranë galerisë së transportit

Në përfundim të punimeve të kërkim zbulimit të minierës do të realizohet sistemimi i sheshit të depozitimit të sterilit. Në shesh do të bëhen punimet për sistemimin e rrjedhjes së ujërave të shiut dhe shmangien nga sipërfaqja e sheshit të rrëqeve me ujë të vrullshëm që mund të destabilizojnë procesin rehabilitues. Subjekti do të ruajë copa të shkëmbinjve me përmasa të ndryshme me qëllim që t'i përdorë për të realizuar shtratin strukturor të sheshit të depozitimit të sterileve ku do të hidhet dhe (masa e dheut që do të gjenerohet nga zbulimi i sipërfaqes së hapjes së galerisë edhe pse e pakët në sasi do të sistemohet dhe ruhet në një vend të caktuar pranë sheshit të sterileve për t'u përdorur për rehabilitimin e mëvonshëm të shesheve të depozitimit të sterileve). Këto copa shkëmbinjsh do të vendosen në mënyrë të tillë që të mund të ndihmojnë në stabilizimin e masës së dheut që do të hidhet dhe të ruajnë atë nga efektet e agjentëve atmosferikë gjëryes – shpëlarës.

c) Hedhja e dheut mbi shtratin e sheshit të depozitimit të mineralit (dhe sterileve)

Dheu i grumbulluar do të sistemohet mbi sheshin e depozitimit të sterileve. Për sistemim do të merret dhe' edhe nga jashtë objektit. Kjo me qëllim që të krijohet një shtrat i thellë tokë që të mundësojë zhvillimin e bimësisë heterogjene dhe të mund të ofrojë kushtet e duhura fiziko – kimike për mbështetjen e botës së gjallë. Në skajin fundor të sheshit do të ndërtohet një mur i thatë guri, i cili do të shërbejë si brez mbrojtës ndaj erozionit të shiut dhe do të ruajë masën e dheut. Masa e dheut që do të hidhet në sheshin e shkallës më pas do të sheshohet, ngjishet dhe nivelohet me mjete të posaçme nga stafi i subjektit. Paralel me sistemimin e dheut do të hidhet pleh organik i cili do të përzihet me masën e dheut (vlerat dhe roli i plehut organik janë të shumta duke filluar nga përmirësimi i cilësive fizike të tokës deri në çlirimin e lëndës ushqyese dhe mbështetjen e mikroorganizmave). E veçanta e përdorimit të plehut organik këtu është që ai do të krijojë kushte për zhvillimin e mikro dhe mezofaunës së tokës e cila zakonisht strehohet në të dhe do të pasurje tokën me lloje). Në përfundim të sistemimit të dheut do të hapen

kanale të vegjël të cilat do të vishen me gurë të përmasave të duhura që të mundësohet drenazhimi i masës së dheut dhe lëvizja e ujërave të tepërta në kohë me reshje që të mos rrezikohet dëmtimi i sheshit dhe zhvendosja e dheut poshtë. Për të siguruar stabilizim më të mirë fizik të volumit të dheut do të vendosen në mënyrë të rregullt gurë dhe sterile të përmasave të ndryshme, të cilët do të luajnë rolin e bërthamave lidhëse të hapsirës dhe dheut. Kjo do të shërbejë për të rritur rezistencën e masës së dheut nga erozioni ujqor dhe i erës si dhe do të lehtësojë formimin e strukturës së dheut duke i dhënë tiparet e një toke.

d) Punimet për maturimin e shtratit të dheut dhe mbjellja e “tapetit të gjelbër”

Para se të realizohet mbjellja e shtratit me llojet që do të përzgjidhen nga subjekti në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në rreth, është e nevojshme që shtrati i dheut të maturohet në mënyrë që të ofrojë kushtet e përshtatshme për mbirjen e farave dhe fidanëve. Gjatë kësaj periudhe kohore masa e dheut do të plehrohet me pleh organik dhe do të punohet me bel. Në përfundim, mbasi të bëhet testimi i shtratit të dheut për filtrimin e ujit, strukturën e ajrosjes, stabilitetin strukturor dhe fizik dhe sidomos për aftësinë ujëmbajtëse, do të përgatitet për mbjellje. Ky operacion do të realizohet menjëherë pas sistemimit – nivelimit të masës së dheut mbi sheshin e depozitimit të sterileve pranë galerive. Mbas ngjeshjes, nivelimit dhe hapjes së kanaleve kullues – drenazhues, sipërfaqja e sheshit do të shkrihet me krehër dhe do të mbillet me farë bari (lilolium ose farë nga bimësia barishtore e zonës si lloji trifolium). Kjo bimësi, duke qenë me sisteme rrënjor xhufkor, do të luajë rolin e stabilizuesit biologjik të masës së dheut në fazat e para të riaftësisimit të tokës dhe fillimit të zhvillimit të proceseve fillestare të formimit të strukturës së tokës dhe raporteve ajër/ujë të agregateve tokësore dhe poreve. Në këtë fazë mund të kryhet një mulcirim i sipërfaqes së mbjellë me një shtresë të hollë plehu organik dhe mbulesë vegjetetale.

e) Mbjellja e fidanëve

Edhe ky operacion do të bëhet në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor mbas një periudhe kohore të caktuar nga realizimi i operacionit të mesiperm. Kjo sepse masa e dheut të sistemuar mbi shesh duhet të jetë stabilizuar dhe të ketë fituar cilësitë e nevojshme për zhvillimin e bimësisë së lartë dhe fidanëve. Mbjellja do të bëhet me fidanë të trajtuar më parë në fidanishte për një periudhe 2-vjeçare, me lloje që garantojnë rezultate të larta në mbirje, prandaj është menduar të mbillen bimë autoktone, të cilat kanë përparësi sepse e kanë më të lehtë të përshtaten. Projekti i mbjelljes do të hartohet me detaje në faqen e parambylljes së minieres dhe do të paraqitet për miratim në organet e mjedisit.

Llogaritja e garancisë financiare për realizimin e planit të reabilitimit për lejen e kërkim zbulimit në bazë të udhëzimit të ministrit të METE-s nr.718 d.t 03/07/2011.

I PLANI I MBYLLJES SE PUNIMEVE TE KERKIM-ZBULIMIT					
Nr	Operacioni	Njesia	Cmimi per Njesi	Vellimi I punes	Vlera n Lek
a	Mbyllje e Hyrjes se galerive me mur.	Nr.Galerish	25 000	1	25 000
d	Mbyllje e puseve te shpimit	Nr.Shpimesh	1 000	2	2 000
Shuma					27 000
II PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE					
Nr	Operacioni	Njesia	Cmimi per Njesi	Vellimi I punes	Vlera n Lek
b	Cmontim , transport I makinerive	Nr.Makinerive	5 000	2	10 000
d	Transporti I kampjonatures se shpimit.	ton	1 000	3	3 000
Shuma					13 000

III	Plani perfundimtar i rehabilitimit				
Nr	Operacioni	Njesia	Cmimi per Njesi	Vellimi I punes	Vlera Lek
a	Tarracimi, sistemimi, rehabilitimi I stoqeve te galerive.	m3	100	90	9 000
b	Tarracimi, sistemimi, rehabilitimi shesheve te shpimit	m3	75	28	2 100
c	Rehabilitimi I stoqeve te sterilizimit nga hapja e karierave te kerkim zbulimit	m3	75	2238	167 850
d	Rehabilitimi I punimeve te kerkimit nga hapja e kanale	m3	50	217.6	10 850
e	Mbjellje pemesh	cope	300	50	15 000
Shuma					204 800
SHUMA I+II+III					244 800
Shpenzime Supplementare 5%					12 240
Totali					257 040

Garancia vjetore financiare = 257 040 leke : 3 vite = 85 680 leke.

ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Mbetjet teknologjike te vetme qe gjenerohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti jane sterilet te cilat do te depozitohen ne sheshet e percaktuara ne projekt. Ato gjate zhvillimi te ketij aktiviteti mund te perdoren si marteriale ndertimi per shtrim rruges etj. Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posaçem dhe do te transportohen drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant te perdoruar do t'u jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne edhe ne Shqiperi (Ministria e Mjedisit posedon nje liste te subjekteve riciklues)

Me qene se kemi te bejme me kerkim-zbulimin e mineralit te kromit ne siperfaqe ne shpatin e nje kodre dhe ne thellesi te saj nevojitet nje monitorim i vazhdueshem jo vetem ne siperfaqen e objektit qe do te shfrytezohet por dhe ne nje zone mbi 300 m per rreth.

- Monitorimi i parametrave gjeometrike te shkalleve te transhes si: pjerresi, lartesia, kendi i skarpates, pjeresia e sheshit te punes si dhe parametrave gjeometrike te parshikuar ne projekt.
- Monitorimi i sjelljes se formacioneve ne kufijte e jashtem te karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundeshme si shkarje, shembje ose vithisje .
- Monitorimi i zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre
- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, grryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre .

- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 4 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane mare nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevojë per sherbime.

Subjekti merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit.

Pergatiti

"Studime Projektme Minerare"

Licensuar nga Q.K.B per sherbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis

License Nr. LN-7543-02-2014

Inxh. Miniere-Markshajder

Halil BULICA

Inxh.Gjeoinxhinier

Denis STASA

Inxh. Ekspert Mjedisor

Hysen DOÇI

